



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
STANDARDET E RAPORTIMIT DHE TË MBIKËQYRJES SË BYROSË
SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 28.01.2010
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 106, datë 30.10.2013
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 153, datë 30.11.2017
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 168, datë 31.08.2018
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 240, datë 12.12.2018

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe standardet e mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, referuar më poshtë si Byroja, përmbajtjen dhe afatet e raportimit të saj pranë Autoritetit.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo Rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të pikës 8 të nenit 42, të Ligjit 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 3 të nenit 14, të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “ Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Neni 3
Qëllimi i Mbikëqyrjes

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbikëqyrja e Byrosë dhe synon:

- a. Garantimin e detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil;
- b. Zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit;
- c. Garantimin e pagesave të dëmeve nga Fondi i Kompensimit;

- d. Zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Këshillin e Byrove;
- e. Zbatimin e detyrimeve të tjera ligjore që lidhet me veprimtarinë e Byrosë.

Neni 4

Mënyrat e Mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e Byrosë, kryhet nëpërmjet raportimit periodik të përcaktuar në këtë rregullore si dhe nëpërmjet inspektimit tematik, nëse Autoriteti e gjykon të nevojshme.
2. Mbikëqyrja nëpërmjet raportimit periodik kryhet nga Zyra e Mbikëqyrjes së BSHS/Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve të cilët shqyrtojnë raportimet periodike të Byrosë.
3. Raportimet periodike të përcaktuara në këtë rregullore do të bëhen sipas formës dhe përmbajtjes së pasqyrave bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
4. Zyra e Mbikëqyrjes së BSHS/Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve ndjekin zbatimin e afateve të raportimit të Byrosë dhe bëjnë kërkesa apo rikujtesa përkatëse.
5. Raportimet e parashikuara në këtë rregullore mund të jenë objekt shqyrtimi edhe nga Drejtoria e Statistikës.
6. Autoriteti nëse e gjykon të nevojshme mund të ushtrojë inspektim në vend, për çështje të caktuara që lidhen me veprimtarinë e Byrosë.
7. Procedura e inspektimit dhe etika gjatë kryerjes së tij bëhet në përputhje me rregulloret e miratuara nga Autoriteti “Për mbikëqyrjen e subjekteve financiare jo bankare”.

Neni 5

Komunikimi me Autoritetin

1. Autoriteti, në kuadrin e ushtrimit të mbikëqyrjes, mund t'i kërkojë Byrosë çdo informacion dhe dokument që ka lidhje me veprimtarinë e saj.
2. Byroja është e detyruar t'i vërë në dispozicion Autoritetit çdo dokument të kërkuar, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 6

Përmbajtja e Raportimit

1. Byroja raporton dhe depoziton në Autoritet:
 - a. Financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit;
 - b. Financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil;
 - c. Statutin e Byrosë apo ndryshimet e tij të propozuara nga Asambleja e

Përgjithshme e Anëtarëve;

- d. Buxhetin e financuar nga anëtarët e Byrosë;
- e. Dokumentacionin për miratim dhe raportin e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar që do të auditojë pasqyrat financiare të Byrosë;
- f. Njoftimin për pajisjen e anëtarëve të Byrosë me certifikata ndërkombëtare të sigurimit (Karton Jeshil);
- g. Emetimin dhe administrimin e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit referuar më poshtë si policë sigurimi dhe shenjës dalluese;
- h. Furnizimin e shoqërive të sigurimit me polica sigurimi dhe shenja dalluese;
- i. Raportin vjetor të veprimtarisë;
- j. Të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera për sigurimet të kërkuara rast pas rasti nga Autoriteti;
- k. Statistika mujore dhe progresive për dëmet Fond Kompensimi.

Neni 7

Financimi i Fondit të Kompensimit

1. Byroja brenda datës 30 nëntor të çdo viti, i propozon për miratim Autoritetit:
 - a. Shumën e kontributeve të çdo shoqërie sigurimi për financimin e Fondit të Kompensimit të vitit pasardhës e përlllogaritur sipas metodologjisë përkatëse;
 - b. Çdo burim tjetër të financimit të Fondit të Kompensimit.
2. Autoriteti miraton çdo vit brenda datës 31 dhjetor, shumën e kontributeve sipas pikave a) dhe b) të paragrafit 1.
3. Parashikimi i primeve bruto të shkruara për llogaritjen e kontributit që duhet të paguajë çdo shoqëri anëtare e Byrosë, për financimin e Fondit të Kompensimit për vitin pasardhës, bëhet mbi bazën e :
 - a. Primeve bruto të shkruara e sigurimit të detyrueshëm motorik të 10 mujorit të vitit paraardhës të marra zyrtarisht nga Autoriteti;
 - b. Mbi bazën e parashikimit 2 mujor të primeve bruto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm motorik, bërë nga çdo shoqëri sigurimi.
4. Llogaritja e Fondit të Kompensimit sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet mbi bazën e axhustimeve të primeve bruto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm motorik të vitit paraardhës, në fund të tremujorit të parë të vitit ushtrimor.
5. Shoqëritë e sigurimit financojnë shtesë të Fondit të Kompensimit në rastet kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat,
6. Shtesa e Fondit të Kompensimit llogaritet në të njëjtin raport që zë çdo anëtar i Byrosë në Fondin e Kompensimit për vitin ushtrimor.

7. Autoriteti miraton shtesën e Fondit të Kompensimit të parashikuar në paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni dhe tabelat e mënyrës së llogaritjes së tij, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit në Autoritet.

Neni 8

Raportimet për administrimin dhe investimin e Fondit të Kompensimit

1. Byroja raporton në Autoritet:
 - a. Brenda datës 10 të muajit pasardhës listën analitike të dëmeve të paguara nga Fondi i Kompensimit si dhe pasqyrën përmbledhëse të dëmeve të raportuara, të paguara dhe pezull, në numër dhe në vlerë të ndara në dëme materiale, shëndetësore dhe jo pasurore;
 - b. Çdo tremujor, brenda datës 10 të muajit pasardhës për financimin, administrimin dhe gjendjen në fund të tremujorit të Fondit të Kompensimit;
 - c. Çdo gjashtë muaj në lidhje me arkëtimet e realizuara nga paditë e kthimit (regresit).
2. Byroja raporton në Autoritet, brenda datës 10 të muajit pasardhës raportin mujor për gjendjen e aktiveve në mbulim të Fondit të Kompensimit, në ditën e fundit kalendarik të muajit përkatës, sipas pasqyrave bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Financimi dhe investimi i Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil

1. Byroja raporton në Autoritet:
 - a. Çdo tremujor, brenda datës 10 të muajit pasardhës, shumën e kontributin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil të çdo anëtari të autorizuar për të lëshuar Karton Jeshil, si dhe kopjet e Garancive Bankare që i korrespondojnë këtij Fondi, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 44 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
 - b. Të gjitha rastet e prekjes së Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 44 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e prekjes së këtij Fondi, si dhe arsyet e kësaj prekjeje;
 - c. Byroja të raportojë në Autoritet, brenda datës 10 të çdo muaji, të gjitha thirrjet e garancive të ardhura në adresë të saj nga Byrotë e huaja të sigurimeve.

Neni 10

Raportimi i Buxhetit

1. Byroja, i propozon për miratim Autoritetit, Projekt Buxhetin për vitin pasardhës, brenda datës 30 nëntor të çdo viti.

2. Financimi i Buxhetit bëhet nga shoqëritë e sigurimit brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij nga Autoriteti.
3. Në rast se Buxheti i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer veprimtarinë e Byrosë, shoqëritë e sigurimit financojnë shtesë të Buxhetit.
4. Byroja raporton në Autoritet financimin e Buxhetit shtesë brenda 10 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së tij në llogarinë përkatëse.

Neni 11

Përmbajtja dhe afatet e raportimeve të tjera në Autoritet

1. Byroja njofton Autoritetin për datën, vendin dhe rendin e ditës së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe Këshillit Administrativ, 5 ditë kalendarike, përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe depoziton në Autoritet një kopje të vendimeve të marra në mbledhje brenda 5 ditëve kalendarike nga zbardhja e tyre.
2. Byroja depoziton në Autoritet:
 - a. Statutin si dhe çdo ndryshim të tij, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e propozimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Autoriteti mund të kërkojë ndryshimin e Statutit nëse bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe ia kthen për rishikim atë Byrosë.
 - b. Ndryshimet apo përmirësimet e Statutit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e miratimit të saj nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Neni 12

Shoqëria e ekspertëve kontabël

1. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe kriteret e auditit, janë të njëjta me ato të përcaktuara në Rregulloren e Autoritetit “Për Ekspertët Kontabël të Autorizuar të shoqërive të sigurimit”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 7, datë 08.02.2007, e ndryshuar.

Neni 13

Procedura e pajisjes së anëtarëve me Karton Jeshil

1. Byroja, depoziton në Autoritet kërkesën e anëtarit për pajisjen me Karton Jeshil brenda 5 ditëve kalendarike nga paraqitja e saj.

2. Autoriteti shqyrton programin e risigurimit, të depozituar nga shoqëria e sigurimit, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në Rregulloren e Autoritetit “Për kriteret e risigurimit”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 18.06.2007.
3. Autoriteti pas shqyrtimit të programit të risigurimit, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, njofton Byronë për përshtatshmërinë ose jo të programit të risigurimit.
4. Byroja, njofton Autoritetin brenda 3 ditëve kalendarike nga data e dhënies së autorizimit anëtarin për të lëshuar Karton Jeshil

Neni 14

Raportimi në Autoritet në lidhje me emetimin dhe furnizimin me policat e sigurimit

1. Byroja depoziton në Autoritet, përpara emetimit, specimenet e policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
2. Të gjithë policat e sigurimit duhet të përmbajnë numrin serial 9 (nëntë) shifror, ku 2 numrat e parë të korrespondojnë me 2 numrat e fundit të vitit korrent për të cilin emetohen policat e sigurimit të përgjegjësishë së pronarit ose përdoruesit të mjetit motorik për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.
3. Byroja fillon procedurën për emetimin dhe prodhimin e policave të sigurimit të detyrueshëm pas dhënies së pëlqimit nga Autoriteti, në përputhje me rregulloret përkatëse të hartuara nga Byroja lidhur me emetimin, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e tyre.
4. Emetimi i policave të sigurimit të detyrueshëm bëhet pas planifikimit duke marrë në konsideratë kërkesat e shoqërive të sigurimit dhe të dhënat e marra nga Autoriteti.
5. Byroja raporton në Autoritet:
 - a. Planifikimin e emetimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit për vitin pasardhës, për çdo shoqëri sigurimi, brenda 5 ditëve nga data e përcaktimit të planifikimit përkatës;
 - b. Prodhimin e policave si dhe çdo kërkesë për shtesë për prodhim policash sigurimi brenda 5 ditëve nga data e prodhimit;
 - c. Informacion të detajuar për sasinë e furnizuara sipas numrave serialë të policave të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit për çdo shoqëri sigurimi, brenda 5 ditëve nga dita e furnizimit të shoqërisë së sigurimit.

Neni 14/a

Asgjësimi i policave të sigurimit

1. Byroja çdo vit bën asgjësimin e policave të sigurimit të vitit paraardhës.
2. Byroja, brenda datës 10 janar të çdo viti duhet të hartojë një raport mbi policat e tërhequra nga secila shoqëri sigurimi, policat e përdorura (shitur, anuluar, dublikata etj.) si dhe policat e pakonsumuara gjatë vitit paraardhës.
3. Raporti duhet të përmbajë:

- a. Numrin e policave me numrat serialë përkatës, të tërhequr gjatë gjithë vitit nga secila shoqëri sigurimi;
 - b. Numrin e policave që janë përdorur nga secila shoqëri sigurimi (shitur, anuluar, dublikate);
 - c. Numrin e policave të papërdorura (të dëmtuara dhe/ose të papërdorura);
 - d. Diferencën ndërmjet numrit të policave të tërhequra në Byro nga shoqëria e sigurimit me policat e përdorura nga kjo shoqëri sigurimi.
4. Raporti miratohet nga Asambleja e anëtarëve të BSHS.
 5. Byroja ia dërgon raportin shoqërive të sigurimit, të cilat brenda datës 15 janar, duhet të dorëzojnë pranë Byrosë listën me sasinë e policave të sigurimit të pakonsumuara nga viti paraardhës.
 6. Byroja për policat e sigurimit të pakonsumuara që dorëzohen nga shoqëritë e sigurimit, duhet të mbajë një procesverbal, i cili nënshkruhet nga dy palët:
 - a. Dorëzuesi, i cili është person i autorizuar nga shoqëria e sigurimit;
 - b. Marrësi në dorëzim, i cili është personi i ngarkuar nga Byroja me marrjen në dorëzim deri në momentin e asgjësimit.
 7. Byroja ngre komisione të posaçme për asgjësimin e policave të sigurimit, të përbërë nga 3-5 anëtarë, ku një nga anëtarët duhet të jetë përfaqësues nga Autoriteti.
 8. Komisioni i ngarkuar me asgjësimin e policave të sigurimit, pasi bën verifikimin e gjendjes fizike të policave të dorëzuara, mban procesverbal ku evidentohet vendi, data, ora, nr.serial i policave të asgjësuar dhe lloji i policës.
 9. Në përfundim të procesit të asgjësimit, Byroja raporton në Autoritet informacion të detajuar për sasinë e policave të asgjësuar për çdo shoqëri sigurimi sipas numrave serialë të policave të sigurimit.

Neni 14/b
Dispozitë kalimtare

1. Emetimi, prodhimi dhe furnizimi me polica të sigurimit të detyrueshëm për vitin 2018, sipas formatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të kësaj rregulloreje duhet të përfundojë brenda datës 31.12.2017.
2. Policat e sigurimit të detyrueshëm, sipas formatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të kësaj Rregulloreje, do të hidhen në treg duke filluar nga data 01.01.2018. Çdo policë e sigurimit e shitur në kundërshtim me formatin e përcaktuar do të konsiderohet e pavlefshme.
3. Policat e sigurimit të detyrueshëm të pakonsumuara në vitet pararendëse të asgjësohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 14/a të kësaj rregulloreje, brenda datës 31.01.2018.

Neni 15
Dispozita të fundit

1. Shkelja e detyrimeve, të përmendura në nenet e mësipërme, nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve, do të dënohet me gjobë sipas nenit 53, të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
2. Pasqyrat bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Elisabeta GJONI
Kryetar

Formular 1

Raport për gjendjen e aktiveve në mbulim të Fondit të Kompensimit

Për Muajin _____ të Vitit _____

Në lekë

<i>Përshkrimi</i>	<i>Gjendja në ditën e fundit kalendarik të muajit paraardhës</i>	<i>Gjendja në ditën e fundit kalendarik të muajit që po raportohet</i>
Depozitë bankare (emri i bankës)		
Letra me vlerë të Qeverisë		
Llogari rrjedhëse		

Datë _____

Personi Përgjegjës

Shënime

Aneksi 1

Byroja Shqiptare e Sigurimit	Dëme Fond Kompensimi						
	St M BsSH						
Periudha e raportimit:	Mujore						
Statusi i dëmit:	Dëme të paguara						
Produkti sigurimit	Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i mjeteve motorike (Kufitare + DMTPL)						
Rendi	Shoqëritë e sigurimit	Numër Dëmi	Numër Kësti	Vlera e dëmeve të paguara			
				Totali në lekë*	ALL	EUR	USD
		1	2	3	4	5	6
1	Albsig						
2	Ansig						
3	Atlantik						
4	Eurosig						
5	Insig						
6	Intersig Vienna Insurance Group						
7	Sigal Uniqa Group Austria						
8	Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group						
	TOTAL						
* Totali në lekë përfaqëson totalin e dëmeve të konvertuara në lekë me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën për të cilën bëhet vlerësimi							

Byroja Shqiptare e Sigurimit	Dëme Fond Kompensimi						
	St M BsSH						
Periudha e raportimit:	Progresive						
Statusi i dëmit:	Dëme të paguara						
Produkti sigurimit	Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i mjeteve motorike (Kufitare + DMTPL)						
Rendi	Shoqëritë e sigurimit	Numër Dëmi	Numër Kësti	Vlera e dëmeve të paguara			
				Totali në lekë*	ALL	EUR	USD
		1	2	3	4	5	6
1	Albsig						
2	Ansig						
3	Atlantik						
4	Eurosig						
5	Insig						
6	Intersig Vienna Insurance Group						
7	Sigal Uniqa Group Austria						
8	Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group						
	TOTAL						
* Totali në lekë përfaqëson totalin e dëmeve të konvertuara në lekë me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën për të cilën bëhet vlerësimi							

Byroja Shqiptare e Sigurimit	Dëme Fond Kompensimi					
			St M BsSH			
Periudha e raportimit:	Progresive					
Statusi i dëmit:	Dëme pezull					
Produkti sigurimit	Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i mjeteve motorike (Kufitare + DMTPL)					
Rendi	Shoqëritë e sigurimit	Numër	Vlera e dëmeve pezull			
			Totali në lekë*	ALL	EUR	USD
		1	2	3	4	5
1	Albsig					
2	Ansig					
3	Atlantik					
4	Eurosig					
5	Insig					
6	Intersig Vienna Insurance Group					
7	Sigal Uniqa Group Austria					
8	Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group					
	TOTAL					
* Totali në lekë përfaqëson totalin e dëmeve të konvertuara në lekë me kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën për të cilën bëhet vlerësimi						

STM BsSH

Dëme të paguara Fond Kompensimi

Kolona “shoqëritë e sigurimit” paraqet: Shoqëritë e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produkti i sigurimit: **Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i mjeteve motorike (DMTPL + KUFITARE)**

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: Totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona “Total” është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve të paguara” paraqet: Shumën e dëmeve të paguara gjatë periudhës.

Shënim: Dëmet e paguara duhet të deklarohen në valutat në të cilat ato janë të paguar. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: Vlerën e dëmeve të paguara në valutat në të cilën është paguar.

Kolona “Numër dëmi” paraqet: Numrin e dëmeve të paguara.

Kolona “Numër kësti” paraqet: Numrin e kësteve të paguara kur dëmi paguhet me këste.

STM BsSH

Dëme pezull Fond Kompensimi

Kolona “Shoqëritë e sigurimit” paraqet: Shoqëritë e sigurimit për të cilat kjo formë do të plotësohet.

Produkti i sigurimit: **Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i mjeteve motorike (DMTPL + KUFITARE)**

Kolona “Total në lekë” përfaqëson: Totalin e konvertuar në lekë të kolonave ALL, EURO,USD.

Shënim: Kursi i konvertimit që duhet përdorur tek kolona “Total” është kursi mesatar i periudhës sipas Bankës së Shqipërisë.

Kolona “Vlera e dëmeve pezull” paraqet: Shumën e dëmeve të pezull gjatë periudhës.

Shënim : Dëmet e pezull duhet të deklarohen në valutat përkatëse. Në rastet kur valuta është e ndryshme nga euro apo dollari amerikan, valuta konvertohet në lekë dhe paraqitet tek kolona në lekë.

Kolonat – Valutave ALL, EURO, USD paraqet: Vlerën e dëmeve pezull në valutat përkatëse.

Kolona “Numri i dëmeve” paraqet: Numrin e dëmeve pezull.

Afati i plotësimit: Çdo datë 10 të muajit pasardhës

Mënyra e plotësimit: Sipas formatit Excel STM BsSH mujor dhe progresive me shkresë dhe në mënyrë elektronike (e-mail).